

The background features a complex network of grey lines and dots, resembling a data visualization or a web structure. There are several teal-colored geometric shapes: a horizontal line with a right-angle turn at the top left, a solid teal square at the top right, a horizontal bar at the bottom left, and a teal triangle at the bottom right.

alGOVrithms 3.0

REKOMANDIME TË POLITIKAVE

Sa janë të automatizuara
procedurat tona publike: Çekia,
Hungaria, Kosova dhe Polonia



TË HAPUR TË DHËNAT KOSOVË

alGOVrithms 3.0

Sa janë të automatizuara procedurat tona publike: Çekia, Hungaria, Kosova dhe Polonia

Autorët:

Michal Škop, Kohovolit.eu – Çeki

Orsolya Vincze, K-Monitor – Hungari

Ariana Gjuli, Open Data Kosovo - Kosovë

Krzysztof Izdebski, Instituti për Drejtësi dhe Shoqëri INPRIS – Poloni

Redaktuar nga:

Ariana Gjuli, Open Data Kosovo - Kosovë

Krzysztof Izdebski, Instituti për Drejtësi dhe Shoqëri INPRIS - Poloni

Koordinatorë e hulumtimit:

Delvina Haxhijaha, Open Data Kosovo - Kosovë

Viti: mars 2023

• Visegrad Fund

Ky projekt është bashkëfinancuar nga qeveritë e Çekisë, Hungarisë, Polonisë dhe Sllovakisë përmes Granteve të Vishegradit nga Fondi Ndërkombëtar i Vishegradit, si dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Koresë. Misioni i fondit është t'i avancojë idetë për bashkëpunim të qëndrueshëm rajonal në Evropën Qendrore.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport fokusohet në përdorimin e sistemeve të automatizuara që ndihmojnë vendimmarrjen në marrëdhëniet qeveri-qytetarë në vendet e synuara: Çeki, Hungari, Kosovë dhe Poloni.

Megjithëse ka shembuj të rinj të përdorimit të vendimmarrjeve të automatizuara (VMA-ve) në sektorin publik, nuk kemi parë një rritje të madhe në dy vitet e fundit. Situata është e ngjashme me rregullimin e transparencës së mjeteve teknologjike dhe zbatimin e politikave dhe strategjive. Qeveritë e BE-së të përfshira në këtë studim duket se janë duke pritur për rregulloren përfundimtare për inteligjencën artificiale (IA), ndërsa neglizhojnë krijimin e një kornize transparente për mjete më të thjeshta algoritmike. Situata është e ngjashme në Kosovë, ku edhe pse është theksuar në raportin e fundit të vitit 2021, puna për rregullimin e transparencës së VMA-ve nuk ka filluar.

Sërish – si në vitin 2019 - veçojmë ato sisteme që funksionojnë në gjyqësor. Këto janë jashtëzakonisht të rëndësishme, pikërisht sepse sistemet që ne kemi identifikuar për caktimin e gjyqtarëve në lëndë kanë ndikim në të drejtën për një gjykim të drejtë.

Ndërsa nuk ka shembuj të sistemeve të tilla për t'i ndihmuar gjyqtarët në shqiptimin e dënimit, ka sisteme të caktimit të lëndëve që kërkojnë procedura të përshtatshme për të siguruar një gjykim të drejtë. Në Poloni, qasja në algoritmin e sistemit të caktimit rastësor të lëndëve të gjykatave të përgjithshme u fitua pas vitesh procesi gjyqësor, por Ministria e Drejtësisë kundërshton nxjerrjen e kodit burimor. Në Hungari ekziston një mjet i ngjashëm, por zbatohet vetëm pjesërisht nga Gjykata Metropolitane e Budapestit. Në Kosovë, Sistemi për Menaxhimin Informativ të Lëndëve përdoret në të gjitha lëndët e gjyqësorit dhe ekziston një kontroll sistematik dhe i pavarur i zbatimit të tij. Administrata Gjyqësore Norvegjeze monitoron zbatimin e projektit dhe ofron ekspertizë të kualifikuar në lidhje me zbatimin e tij. Raporti sugjeron nevojën e futjes në zbatim të mekanizmave për të siguruar transparencë më të madhe dhe mundësinë që auditorët kompetentë dhe të pavarur të monitorojnë përdorimin e këtyre mjeteve në Poloni dhe Hungari, duke pasur parasysh problemet me sundimin e ligjit në ato vende.

Ne paraqesin edhe shembuj të tjerë të përdorimit të VMA-ve. Është interesante se shumica e sistemeve që kemi identifikuar kanë për qëllim përmirësimin e kontrollit shtetëror mbi qytetarët. Qoftë fjala për kontrollin e shpejtësisë, përdorimin e sistemeve të njohjes së fytyrës apo, së fundi, mjetet për t'i kontrolluar llogaritë bankare të qytetarëve.

Ka pak mjete që përmirësojnë drejtpërdrejt mirëqenien e qytetarëve. Megjithatë, vërejmë se sistemet e krijuara për të ndikuar në kursimin e energjisë po bëhen të njohura.

Kjo mund të jetë për faktin se qytetarët, akademikët dhe organizatat e shoqërisë civile nuk janë ende të përfshirë në proceset e planifikimit të mjeteve algoritmike dhe nuk konsultohen për rreziqet e mundshme.

Kjo është edhe një tjetër arsye pse rekomandimet e nxjerra duhet të marrin jehonë. Më poshtë janë rekomandimet e përgjithshme që duhet të zbatohen nga të gjitha vendet, dhe në seksion do të gjeni rekomandime të adresuara në mënyrë specifike për qeveritë kombëtare për secilin prej vendeve.

- Futja e një kornize sistematike për transparencën algoritmike:

- Ngritja e kapaciteteve në mesin e zyrtarëve dhe përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile:

- Futja e një kornize sistematike për vlerësimin e performancës së VMA-së:

RRUGA PËRPARA 2023

Rekomandime të politikave për sa i përket vendimmarrjes së automatizuar në Çeki, Hungari, Kosovë dhe Poloni

Nisur nga specifikat e secilit prej vendeve të studiuara, si në aspektin e kulturës politike ashtu edhe në aspektin e përparimit të përgjithshëm teknologjik, ne kemi zgjedhur të bëjmë rekomandime veç e veç për secilin vend. Megjithatë, është e mundur të identifikohen zgjidhje universale që duhet të zbatohen, si në secilin prej vendeve të studiuara, ashtu edhe kudo që ka ambicie që zhvillimi i TI-së të lidhet me shqetësimin për të drejtat e njeriut dhe vlerat demokratike. Këto janë:

- Futja e një kornize sistematike për transparencën algoritmike:

Kjo duhet të bazohet në disa nivele. Komunikimi i qartë i parimeve bazë të algoritmit, p.sh. në faqen e internetit të subjektit që zbaton algoritmin. Çfarë të dhënash përdoren, cilët janë mekanizmat për kombinimin e tyre, kush është autori i teknologjisë, kush është përgjegjës për funksionimin e saj dhe, në fund, si të ankoheni për rezultatin e gjykimit. Niveli tjetër është të vihet në dispozicion përmbajtja e algoritmit dhe kodi burimor. Në parim, VMA-të e përdorura nga autoritetet publike duhet të bazohen në të ashtuquajturin kod me burim të hapur.

- Ngritja e kapaciteteve në mesin e zyrtarëve dhe përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile: Ekziston një nevojë urgjente për të forcuar njohuritë dhe kompetencat digjitale midis atyre që përdorin VMA dhe atyre që mund të vlerësojnë performancën e tyre, p.sh. kundër rreziqeve të diskriminimit. Trajnimi, ndonëse kryhet veçmas për secilin prej këtyre grupeve, duhet të përfshijë edhe elemente të një përplasjeje këndvështrimesh të ndryshme – qytetare dhe zyrtare.

- Futja e një kornize sistematike për vlerësimin e performancës së VMA-së:

Kjo duhet të ndodhë që në fazën e planifikimit të krijimit ose blerjes së mjetit, por edhe gjatë gjithë ciklit jetësor të përdorimit të tij. Organizatat e Shoqërisë Civile dhe institucionet e pavarura të auditimit duhet të jenë akterë të rëndësishëm në këtë proces.

Bazuar në gjetjet nga secili prej vendeve të synuara, rekomandimet e mëposhtme duhet të merren parasysh:

Çekia

-Duhet të ketë një kornizë të qartë ligjore që rregullon përdorimin e alGOVrithm-ave.

Siç u demonstrua në rastin e njohjes së fytyrës në aeroportin e Pragës, sistemi rregullohej nga disa dokumente ligjore dhe ka ende pyetje të rëndësishme ligjore të hapura në lidhje me sistemin. Ky është një hap i rëndësishëm drejt garantimit që përdorimi i alGOVrithm-ave të bëhet brenda një kornize ligjore që është transparente dhe e drejtë.

-Transparenca duhet të jetë një element kyç i çdo sistemi të alGOVrithms.

Algoritmet e përdorura në sistemin e njohjes së fytyrës dhe në sistemin e kontrollit të parkimit nuk janë fare të disponueshme publikisht. Prandaj, duhet të ketë një shtytje drejt transparencës më të madhe në këto sisteme. Algoritmet e përdorura në sistemet publike duhet të vihen në dispozicion për shqyrtim publik për të siguruar që ato të mos përjetësojnë gabime, paragjykime ose praktika diskriminuese.

-Duhet të ekzistojë një mekanizëm i pavarur mbikëqyrës për të siguruar që alGOVrithm-at përdoren në mënyrë etike dhe të përgjegjshme.

Mekanizmi i mbikëqyrjes duhet të jetë një organ i pavarur me kompetencë për të audituar dhe shqyrtuar përdorimin e alGOVrithm-ave në fusha të ndryshme, duke përfshirë sigurinë publike, kontrollin e parkimit dhe paralajmërimet e motit.

-Duhet të ketë një shtytje drejt përdorimit të algoritmeve me burim të hapur në sistemet publike.

Algoritmet me burim të hapur janë algoritme, kodi burimor i të cilëve është i disponueshëm publikisht, duke i lejuar kujtdo që t'i shqyrtojë, modifikojë dhe përdorë ato. Kjo qasje mund të ndihmojë në promovimin e transparencës dhe përgjegjshmërisë në sistemet e alGOVrithms.

-Duhet të ketë një përpjekje për të edukuar publikun rreth alGOVrithm-ave dhe përdorimit të tyre në fusha të ndryshme. Publiku duhet të informohet për përfitimet dhe rreziqet e këtyre sistemeve. Kjo mund të bëhet përmes fushatave të ndërgjegjësimit publik, konsultimeve publike dhe nismave të angazhimit të komunitetit.

Hungaria

-Transparenca duhet të jetë një parim udhëzues:

- Sistemet e trashëguara dhe softuerët IT të jashtëm për VMA duhet të rishikohen në mënyrë që të zëvendësohen nga zgjidhje me burim të hapur
- Duhet të krijohet një bazë qendrore qeveritare e të dhënave, ku publiku të mund të qaset në informacionin për të gjitha alGOVrithm-at ku bëhet vendimmarrja dhe profilizimi i automatizuar.

-Arsimi është faktori më i rëndësishëm në të ardhmen e afërt:

- Akteve duhet t'u sigurohet informacion gjithëpërfshirës dhe i kuptueshëm për të drejtat e tyre.
- Qasja e të drejtave themelore duhet të shpërndahet edhe në administratën publike, veçanërisht në zonat ku zhvillohen, projektohen dhe prokurohen VMA të tilla.
- Krijimi i një dialogu civil dhe të palëve të interesuara me autoritetet publike

Kosova

-Strategjia Kombëtare për Mbështetjen e përdorimit të IA në procedurat publike

-Përfshirja e një objektivi specifik që i referohet përdorimit të Inteligjencës Artificiale (IA) (përdorimi i algoritmeve në vendimmarrje) si pjesë e Strategjisë së Agjendës Digjitale, ose strategjisë së e-Qeverisjes për Kosovën;

-Krijimi i një regjistri të IA

-Pas zbatimit të rekomandimit të parë, është e rëndësishme të zhvillohet një Regjistër publik i IA si një mjet i standardizuar dhe i qasshëm për të dokumentuar vendimet që janë marrë në procesin e zhvillimit dhe zbatimit të një algoritmi në procedurat e vendit.

-Promovimi i alGOVrithm-ave ekzistuese

-Përqendrimi në promovimin e rasteve ekzistuese në lidhje me përdorimin e alGOVrithm-ave si pjesë e procedurave publike dhe informimi i publikut për rëndësinë e tyre;

- Ndërveprueshmëri më e mirë

-Sigurimi i ndërveprimit më të mirë ndërmjet institucioneve shtetërore (si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal) në lidhje me zbatimin e algoritmeve që synojnë të avancojnë vendimmarrjen e automatizuar;

Polonia

-Zbatimi i legjislacionit që vendos një detyrim të qartë për të vënë në dispozicion përshkrimin e funksionimit të algoritmeve, si dhe për të publikuar një kod burimor të sistemeve të automatizuara të vendimmarrjes. Kufizimet mund të lindin vetëm në raste të përcaktuara rreptësisht si siguria ose konfidencialiteti i biznesit të përcaktuar ngushtë.

-Zbatimi i një sistemi të automatizuar të vendimmarrjes që prek të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve duhet të paraprihet detyrimisht nga një vlerësim i ndikimit duke marrë parasysh, ndër të tjera, efektet në rrezikun e diskriminimit. Veçanërisht në rastin e mjeteve të zbatuara nga gjyqësori dhe prokuroria.

-Duhet të ketë përpjekje sistematike për të përmirësuar kompetencën e zyrtarëve (por gjithashtu, për shembull, gjyqtarëve) përgjegjës për zbatimin dhe funksionimin e sistemeve të automatizuara të vendimmarrjes. Sidomos në lidhje me vlerësimin e rreziqeve të mundshme për të drejtat e njeriut.

-Është gjithashtu e nevojshme të organizohen aktivitete sistematike për rritjen e kompetencës së përfaqësuesve të OJQ-ve, gazetarëve dhe akademikëve në identifikimin e rreziqeve specifike që dalin nga funksionimi i sistemeve të automatizuara të vendimmarrjes.

-Institucionet publike (si ato që veprojnë në nivel lokal dhe qendror, ashtu edhe gjykatat dhe prokuroritë) duhet të publikojnë paraprakisht planet për ngritjen ose prokurimin e sistemeve të automatizuara të vendimmarrjes, së bashku me informacionin bazë mbi qëllimet e synuara të funksionimit të tyre.

Ky projekt është bashkëfinancuar nga qeveritë e Çekisë, Hungarisë, Polonisë dhe Sllovakisë përmes Granteve të Vishegradit nga Fondi Ndërkombëtar i Vishegradit (Granti i Vishegradit nr. 22220279), si dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Koresë.

mbështetur nga

• **Visegrad Fund**



Ministria e Punëve të Jashtme
Republika e Koresë

PARTNERËT E PROJEKTIT:



INPRIS



MONITOR



kohovolit.eu

OPEN DATA KOSOVO

The background features a complex network diagram with grey nodes and lines. A teal square is in the top right, and teal lines are in the top left and bottom left. The title 'alGOVrithms 3.0' is in a bold, dark blue font.

alGOVrithms 3.0

REKOMANDIME TË POLITIKAVE

**Sa janë të automatizuara
procedurat tona publike: Çekia,
Hungaria, Kosova dhe Polonia**